



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.379/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Cocaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.379/2025, e datës 05.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.02.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PLE në të cilën thekson se në tubimin politik të IRDK-së, të mbajtur më 03 Shkurt 2025 në Fushë Kosovë në kuadër të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Nacionale në Kosovë, z.Fridon Lala, deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovë nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, bazuar në video-incizimin e bashkëngjitur në cilësi të provë në këtë ankesë ku tregon *"një bisedë të vjetër me një gjakovar, i cili gjatë një udhëtimi në Afrikë e kishte pas marrë një tigër me veti në Gjakovë edhe pas disa viteve kishte marrë pjesë në një kontest të dyluftimi të maceve, edhe aj normalisht tigri nuk u dukej mo tigër, por si macë...dhe ata e pyetin se si e kan trajtua kështu, dhe ky ia kthen që me thonë të vërtetën është tigër por prej keqshqyerjes po doket si macë...edhe krejt këtë energji në Fushë Kosovë me Idrizin dhe Arjetën (kandidatë për deputet), edhe do luana të Fushë Kosovës keni me i lënë unë me vota saqë kanë mu dok si qato macet ... "*. Gjithashtu, në fjalimin vijues, z.Lala përmend aktivitetin politik të një dite të mëparshme të subjektit tonë politik PLE, të mbajtur në Fushë Kosovë, duke e quajtur kryetarin e subjektit politik PLE "kryedemagog" dhe në bazë të këtij fjalimi kuptohet shumë qartë që biseda e sipër përmendur i referohet pikërisht subjekti tonë politik PLE, duke e personifikuar si "macë", duke përdorur në kontekstin negativ, fyese,urrejtje

dhe duke përhapur narrativë denigruese në diskursin publik në kundërshtim me Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 34, paragrafi 1, pika 11.

Si provë ka bashkangjitur fotografitë e postuara në facebook.

Më datë 06.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 06.02.2025, deri në ora 19:00.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik IRDK ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se nuk qëndrojnë pasi që Fridon Lala gjatë fjalimit të tij në tubim ka përdorur gjuhë stilizuese dhe jo gjuhë të urrejtjes, në përmbajtje të fjalës së tij përdorimi i figurave stilistike të "tigrin" e "maces" përçon patjetër mesazh politik por nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë si gjuhë e urrejtjes apo të nxitjes për urrejtje a dhunë, andaj e njëjta çështje i lihet në vlerësim vet autoritetit të PZAP me ç'rast edhe do ta vërtetoj këtë konstatim që përbën arsye të qëndrueshme se kjo ankesë duhet të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.


Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që nga video e cila është publikuar në rrjete sociale, ku dëgjohen deklaratat e kandidatit për deputet të subjektit politik IRDK, e të cilat deklarata nuk mund të vërtetohen se janë me përmbajtje të nxitjes se urrejtjes, të njëjtat deklarata sipas panelit konsiderohen diskurs që zakonisht përdoret gjatë fushatave zgjedhore, prandaj si të tilla nuk mund të konsiderohen si shkelje të pretenduara nga pala ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, pasi që nuk ka ofruar asnjë provë për vërtetimin e këtyre shkeljeve.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 379/2025 më datën 07.02.2025

Kryesuese e Panelit,
Kymete Kicaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenet 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.